



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Patos, më 02/06/2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtim i stacionit të pompimit Belinë”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punë ndërtimore kod 45.

VLERA E FONDIT LIMIT: **13,199,791 (trembëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH**, vënë në dispozicion nga të Ardhurat Lokale 2023 Kontraktori është i detyruar të përfundojë të gjitha punimet (volumet e parashikuara në preventiv) sipas afateve të zbatimit të punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve përkatëse.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar)

**2.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **13,199,791 (trembëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

---

**Fondi limit = 13,199,791 (trembëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë.**

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2021,2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ligjore nr.10091 datë 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të

*ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.(i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, kudo ku operatori ushtron aktivitetet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2022.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).*

**Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

*Referuar sa më sipër, njësitë e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësaj prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllorë të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
- ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. *Situacion përfundimtar të objektit,*
- iii. *Aktin e Kolaudimit të objektit,*
- iv. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.9*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. *Situacion përfundimtar të objektit,*
- iii. *Aktin e Kolaudimit të objektit,*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

**13,199,791 x 50% = 6,599,895.5 Leke**

**13,199,791 x 2 = 26,399,852 Leke**

---

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjiise, ne baze te VKM Nr 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP-1: Punime germimi ne toke "Kategoria A".
- b. NP-2: Ndërtime civile e industriale "Kategoria A".
- c. NP-7: Ujësjetllës, gazsjellës, vajsjetllës, vepra kullimi e vaditje "Kategoria A".
- d. NP-9: Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. "Kategoria A".
- e. NS-1: Punime për prishjen e ndërtimeve. "Kategoria A".
- f. NS-9: Punime strukturore speciale "Kategoria A".

Ne rast bashkimi operatoresh secili duhet te disponoje kategorite e licences sipas marreveshjes se bashkepunimit.

- **NP-1: Punime germimi ne toke "Kategoria A"**

*Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.*

- **NP-2: Ndërtime civile e industriale "Kategoria A"**

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.*

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderrur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.*

- **NP-7: Ujësjetllës, gazsjellës, vajsjetllës, vepra kullimi e vaditje "Kategoria A".**

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.*

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.*

➤ **NP-9: Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.**

**“Kategoria A”.**

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme.*

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.*

➤ **NS-1: Punime për prishjen e ndërtimeve**

**“Kategoria A”**

*Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.*

➤ **NS-9: Punime strukturore speciale.**

**“Kategoria A”**

**A”**

*Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistonte dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese.*

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përshtirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratorit nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve.*

*Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve.*

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime germimi ne toke	Prerje bime e shkulje rrenje Fi deri ne 10 cm	Kategoria A	<20 milion
		Prerje peme me Fi 10-20 cm		
		Germim e zbankim dheu, 60 % me makineri, në të gjithë zonen ku do te ndertohet stacioni i pompimit		
		Rashfim skarpate ne germim me makineri		
NP-2	Ndërtime civile e industriale	Shtrese betoni M 200 , t= 20 cm e perforcuar me hekur 100 mm per bazamentin e dyshemese se katit 0,00	Kategoria A	<20 milion
		Mur me tulle te plota ne lartesi deri 3m me llaç perzier M 25		
		B/arme M - 250 per soleten t= 16 cm		
		Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m.		
		Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m.		
		Shtrese betoni per trotuare, C12/15		
		F.V. hekur betoni.		
		F V hekur betoni ne b/arme Ø 6 - 12 mm.		
		F.V. detaje metalike.		
		F.V. profil dopjo "I" N.28.		
		Shtrese betoni C 7/10		
		Shtrese beton M250 e derdfhur ne forme pllakash rrombique 0.4x0.4 m per dyshemene e stacionit		
		Boje vaji mbi konstruksione metalike.		

		Suvatim I brendshem.		
		Suvatim fasade me granil e cemento te bardhe.		
		Konstruksione metalike per mbulimin e ngrehines		
		Cati (e lehtesuar) me kapriata metalike dhe mbulesa plastike te valezuar		
		F.V.dyer metalike me llamarine te zeze (27.75 kg /m2) cope dy		
		Dritare d/alumini tek xham.		
		F. V dritare metalike me zhaluze ajrimi , 1.4x1.6 m (BxH)		
		Shkalle metalike me llamarine te riguar + shesh pushimi		
		Parmak me tubo xingato per shkallet dhe per hapesiren e ngritjes se pompave ne katin e Pare te ngrehines , kuota 14,85 ( analize per 1 ml parmak)		
		Rrethim me tel me gjemba 6 fije teli dyfijesh ne lartesi 1,75 cm me gjemba ne çdo 10 cm gjatesi ( analize per 1 m2 )		
		F V porte metalike 3,3 x 1,8 m ( shih analizen)		
NP-7	Ujësjetës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje	Germim dheu per vasken dhe themelet		<20 milion
		Mbushje e ngjeshje me dhe		
		Beton M150 per muret e vaskes		
		Beton M 150 tabani i vaskes dhe pragu hyrjes		
		Beton M 250 per soletat e sherbimit		
		F. V tub çeliku Fi 463/6.3 mm (dy tuba)		
		F.Vendosje zgarë metalike ne forme koshi me flanaxhe per mbrojtjen e tubit thithes		
		Konstruksione metalike , bryla , rakordime etj.		
		Hekur betoni per soleten e sherbimit		
		Lyrje me boje antiruxho ( nje dore emulsion + dy dore boje)		
		F+Vendosje porta metalike te galvanizuara 150x180 cm me aks te gjate ne hyrje te vaskave ( gjithesjt cope 2 )		



		Germim dheu 95 % me makineri per kanalin e furnizimit te stacionit		
		Rafshim skarpate ne germim per kanalin e furnizimit		
		Beton M 200 per veshjen e kanalit e pragut ne hyrje te vaskes		
		Ndertim penel mbrojtjes me rrjet gabioni e gure kave ne krahun e majte te rrjedhes ne vijim te vaskes se thithjes ( analize per 1 m3)		
NP-9	Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime	Germim dheu per vasken dhe themelet		<20 milion
		Mbushje e ngjeshje me dhe		
		Beton M150 per muret e vaskes		
		Beton M 150 tabani i vaskes dhe pragu hyrjes		
		Beton M 250 per soletat e sherbimit		
		F. V tub çeliku Fi 463/6.3 mm (dy tuba)		
		F.Vendosje zgare metalike ne forme koshi me fllanxe per mbrojtjen e tubit thithes		
		Konstruksione metalike , bryla , rakordime etj.		
		Hekur betoni per soleten e sherbimit		
		Lyrje me boje antiruxho ( nje dore emulsion + dy duar boje)		
		F+Vendosje porta metalike te galvanizuara 150x180 cm me aks te gjate ne hyrje te vaskave ( gjithesjt cope 2 )		
		Germim dheu 95 % me makineri per kanalin e furnizimit te stacionit		
		Rafshim skarpate ne germim per kanalin e furnizimit		
		Beton M 200 per veshjen e kanalit e pragut ne hyrje te vaskes		
		Ndertim penel mbrojtjes me rrjet gabioni e gure kave ne krahun e majte te rrjedhes ne vijim te vaskes se thithjes ( analize per 1 m3)		
		Germim dheu per kanale ( 60 % makineri)		

		Mbushje e ngjeshje me dhe		
		Beton M 150 per blloqe mbeshtetes pergjate tubacionit		
		Beton M 200 per puseten e daljes		
		Hekur betoni per blloqet e ankorimit dhe zgaren e perforcimit ne pusten e daljes		
		F. V tub çeliku Fi 345/5.6mm		
		Hidroizolim tubi (nje dore emulsion e dy duar bitum)		
		F.Vendosje saraçineska gize Fi 300 mm , P = 10 at		
		F.Vendosje porte metalike 60x80 cm ( bxH)		
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prerje bime e shkulje rrenje Fi deri ne 10 cm		<20 milion
		Prerje peme me Fi 10-20 cm		
		Germim e zbankim dheu, 60 % me makineri, në të gjithë zonën ku do të ndërtohet stacioni i pompimit		
		Rashfim skarpate ne germim me makineri		
NS-9	Punime strukturore speciale	Cpim me sonda UKS dhe Betonim pilota b/arme , Fi 80 cm , Lmes = (12-14) ml , per mbeshtetjen e platformes te stacionit te pompimit ( analize per 1 ml )	Kategoria A	<20 milion
		Cpim e Betonim pilota b/arme , Fi 80 cm , Lmes = (12-14) ml , per mbeshtetjen e platformes te stacionit te pompimit e te vete pompave ( analize per 1 ml )		
		Betonim pilota b/arme , Fi 60 cm , Lmes =2.50ml , per mbeshtetjen e soletes se katit te dyte( analize per 1 ml )		
		Shtrese betoni M 200 , t= 20 cm e perforcuar me hekur Fi 6 mm per bazamentin e dyshemese se katit 0,00		

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. Inxhinier ndertimi 1 (nje)
- b. Inxhinier elektrik 1 (nje)
- c. Inxhier hidroteknik 1 (nje)

Per kete duhet te paraqes Diplome, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2023e ne vazhdim. ne fazen e ofertimit Operatori ekonomik ploteson formularin permbledhes te vetedeklarimit,

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. 1 (nje) punonjes të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier“.

Per kete duhet te paraqes Diplome/Certifikate, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e ne vazhdim.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. **Teknike ndertimi 1 (nje)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2023 e ne vazhdim.
- a. **Karpentiere 3 (tre)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2023 e ne vazhdim.
- b. **Hekurkthyes 2(dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2023 e ne vazhdim.
- c. **Muratore 2(dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2023 e ne vazhdim.
- d. **Suvatues 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2023 e ne vazhdim.

- e. **Hidroizolues 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2023 e ne vazhdim.
- f. **Puntore te thjeshte 5 (pese)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2023 e ne vazhdim.
- g. **Elektriciste 2 (dy)** per per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2023 e ne vazhdim.
- h. **Shofere 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, leje drejtimi, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2023 e ne vazhdim. ( Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkoht domosdoshmërisht të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).
- i. **Manovratore 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme leje drejtimi, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figurojne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2023 e ne vazhdim.. ( Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkoht domosdoshmërisht të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- diplome,
- kontrata pune,
- deshmi kualifikimi
- Ne raste kur makinerite disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar.

**Personeli i mësipërm kërkoht në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Inxhinieri i Ndertimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve te objektit qe prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për ndërtimin e objektit, zberthimin e projektit konstruktiv, punimet e betonit të hekurit, punimet e muraturës, shtresave të rruges etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh të betonit, hekurit etj.
- **Inxhinieri Elektrike** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve te objektit qe prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për ndërtimin e objektit, zberthimin e projektit elektrik, punimet e instalimeve elektrik te ndricimit etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh tela dhe kablllo te percjelljes te energjise elektrike, ndricuesit qe do te vendosen etj.
- **Inxhinier hidroteknik** ehte përgjegjës per zbatimin e sakte te punimeve te rrjeti inxhinirik te objekti qe prokurohet per secilin nga zerat e punimeve qe mbulon, per zberthimin e projektit te kanalizimit te ujrave te zeza dhe te bardha (KUZ dhe KUB), punimet per montimin e sakte te tubove dhe linjeve te ndryshme hidraulike qe vendosen ne object.
- **Teknike ndertimi** (ose ing ndertimi ne zbatim) është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve ne kantierin e projektit object prokurimi për realizmin e sakte te kuotave dhe

shtresave te rruges, kuotave te nenshtresave, dhe kuotave dhe dimensioneve të kanalizimit te ujrave te shiut ne trupin ose ne anet e rruges.

- **Karpentiere** eshte pergjegjes per pergatijen e armatures se derrases dhe betonimin e sakte te strukturave beton dhe beton arme te perfshira ne objektin qe prokurohet
- **Hekurkthyesi** eshte pergjegjes per kthimin dhe lidhjen e sakte te hekurit dhe vendosjen e datajeve metalike ne strukturat b/a te perfshira ne objektin qe prokurohet.
- **Muratori** eshte pergjegjes per vendosjen e sakte te mureve mbajtese, ndarese te ndertuara me materiale guri, tulle, blloqe betoni apo cdo element tjetër qe sherben apo zevendeson ato, te perfshira ne objektin qe prokurohet.
- **Suvatues** eshte personi pergjegjes per suvatimin e mureve te gurit, tulles blloqeve etj me llac gelqere. Te perzier , cemento, te patrapergatitur etj , me pompe suvatimi apo me krahe, te perfshira ne objektin qe prokurohet.
- **Hidroizolues** eshte pergjegjes per ndertimin e sakte te shtresave hidroizoluese te ndertesës, te ndertuar me bitum, primer, shktresa kartoni katrama, guajne, matreaile bikomponenteshe etj, te perfshira ne objektin qe prokurohet
- **Shofere** jane personat pergjegjes per drejtimin e makinerive ne kantiar dhe jashte kantierit per furnizimin dhe transportin e materialeve te nevojshme per objektin qe prokurohet. Ne raste kur makinerit dispononohen me qera, keta punonjes do te jene te kontraktuar.
- **Manovratore** jane personat pergjegjes per drejtimin e makinerive dhe pajijeve te ndertimit ne kantiar dhe jashte kantierit per kryerjen e proceseve te caktuara te puneve ( psh. presa/pompa betoni,ekskavatore germim, mini fadroma, skre te llojeve te ndryshme etj) te nevojshme per objektin qe prokurohet. Ne raste kur makinerit dispononohen me qera, keta punonjes do te jene te kontraktuar.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**2.3.6.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 26 (njetzet e gjashte) persona.**

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

- a) *Vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vule elektronike .*
- b) *Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)*

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

Ne objektin “Ndertim i godines se stacionit te pompimit Beline” proceset e punes klasifikohen ne keto kategori:

**a) Punime per mobilizimin e kantierit**

Ne keto punime perfshihet pergatitja e kantierit per fillimin e punimeve. Gjate kesaj kohe do t percaktohen furnitoret dhe vendet e depozitimit te materialit. Do te stukturohet organika e njerezve qe do te punojne ne kantier dhe do te behet konturimi i kantierit me hyrje-daljet e tij. Afati i parashikuar 6 dite pune. Puntore te angazhuar: 1 specialist dhe 2 puntore. Makineri Kamiocine dhe/ose pick-up.

**b) Punime betoni e b/a.**

- **Volumi I punimeve** **150 m2.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **522 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.287 m3/op**

Keto punime perfshijne prishjen e shtresave dhe strukturave ekzistuese apo zerave te vecante ne preventiv. Orari nominal mesatar per punimet e prishjes eshte ne trupin e rruges eshte rreth 3.48 ore/m3. Referuar grafikut qe parashikon afatin 64 dite pune, fuqia puntore duhet te jete 5 here me shume, ose 3specialiste dhe 2 puntore. Makinerite qe nevojiten jane:, 1 kamiocine deri ne 3.5 ton, trako, matrapik elektrik, depozite uji, pompe uji etj.

**c) Punime murature.**

- **Volumi I punimeve** **12 m3.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **77 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.155 m3/op.**

Keto punime perfshijne vendosjen e shtresave te hidroizolimit dhe termoizolimit ne tarrace. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 10 dite pune, orari mesatar i punimeve 6.42 ore/m3. Per realizimin e ketyre punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 2 specialiste dhe 2 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 kamiocine deri ne 3.5 ton, 1 gjenerator,betoniere, etj.,

**d) Punime Suvatimi e bojatisje.**

- **Volumi I punimeve** **93 m2.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **154 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.604 m2/op.**

Keto punime perfshijne vendosjen e shtresave te hidroizolimit dhe termoizolimit ne tarrace. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 21 dite pune, orari mesatar i punimeve 1.66 ore/m2. Per realizimin e ketyre punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 2 specialiste dhe 2 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 kamiocine deri ne 3.5 ton, 1 gjenerator, 1 pompe llaci, etj.,

**e) Punime dyer e dritare.**

- **Volumi I punimeve** **10.5 m2.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **184 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.057 m2/op.**

Keto punime perfshijne vendosjen e shtresave te hidroizolimit dhe termoizolimit ne tarrace. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 14 dite pune, orari mesatar i punimeve 17.52 ore/m2. Per realizimin e ketyre punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 2 specialiste dhe 2 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 kamiocine deri ne 3.5 ton, 1 gjenerator, etj.,.

**f) Punime instalime elektrike e mekanike.**

- **Volumi I punimeve** **.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **384 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **/op.**

Keto punime perfshijne vendosjen e shtresave te hidroizolimit dhe termoizolimit ne tarrace. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 22 dite pune. Per realizimin e ketyre punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 4 specialiste dhe 4 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 kamiocine deri ne 3.5 ton, 1 gjenerator, 1 kanello me gaz, 2 bombula gazi etj.,.

**g) Punime instalimi I elktropompave.**

- **Volumi I punimeve** **2 cope.**
- **Koha e nevojshme per perfundimin e punimeve** **134 op.**
- **Norma mesatare e punimeve** **0.754 m2/op.**

Keto punime perfshijne vendosjen e shtresave te hidroizolimit dhe termoizolimit ne tarrace. Parashikimi i kohezgjatjes se punimeve 13 dite pune, orari mesatar i punimeve 1.33 ore/m2. Per realizimin e ketyre punimve ne afatin e parashikuar nevojiten 2 specialiste dhe 2 puntore. Makineri dhe mjete te angazhuara per kete proces pune: 1 kamiocine deri ne 3.5 ton, 1 gjenerator, i autobetoniere, i pompe betoni, 1 kanello me gaz, 2 bombula gazi etj.,.

**h) Punime per demobilizimin e kantierit**

Per demobilizimin e kantierit duke gene se jane disa nenobjekte, me perfundimin e secilit nenobjekt behet largimi i makinerive dhe pajisjen nga vendi i ndertimit (minikantieri) per dorezimin e punimeve te realizuara eshte parashikuar nje periudhe kohore prej 6 dite pune. Puntore te angazhuar per realizimin ne afat te ketij demobilizimi duhen 1 specialist +1 puntor. Makineri dhe pajisje te nevojshme per kete faze: 1 kamioncine.

*Referuar kategorise se punimeve si dhe afatit, stafi i kerkuar duhet te jete:*

- *Teknike ndertimi* 1 (nje)
- *Karpentiere* 3 (tre)
- *Hekurkthyes* 2 (dy)
- *Murator* 2 (dy)
- *Suvatues* 2 (dy)
- *Hidroizolues* 2 (dy)
- *Puntore te thjeshte* 5 (pese)
- *Elektriciste* 2 (dy)
- *Shofere* 2 (dy)
- *Manovratore* 2 (dy)
- *Drejtues Teknik* 3 (tre)

**TOTALI = 26 Persona ne Staf (njezet e gjashte).**

*Shenim: Argumetnimi i nr. te punonjeseve behet vetem me qellim per justifikimin e stafit te kerkuar. Ndarja sipas specialiteteve ne kete rubrike te mos merret ne konsiderate ne plotesimin e kriterëve te percaktuara.*

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- **Kamion me aftesi mbajtese mbi/ose 20 ton** cope 2 (dy)
- **Kamiocine me aftesi mbajtese (2 deri ne 3.5 ton)** cope 1 (nje)
- **Ekskavator me goma 0.25 m3** cope 1 (nje)
- **Ekskavator me zinxhire 0.5 m3** cope 1 (nje)
- **Sonde per "UKS"** cope 1 (nje)
- **Skrep** cope 1 (nje)
- **Mini Fadrome** cope 1 (nje)
- **Vibrator betoni thellesie** cope 2 (dy)
- **Autovinc jo me pak se 5 ton** cope 1 (nje)
- **Gjenerator jo me pak se 3.5 KVA** cope 1 (nje)

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit.
- kolaudimin,
- certifikatë transporti



- fotografi të mjetit te paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit).

Për mjetet dhe pajisjet te cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
- fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimit të mjetit.

*Pranohet marrja me qera e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë object.*

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).***

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme në lidhje me stafin dhe mjetet e nevojshme për realizimin e kontratës janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

### 2.3.9: Certifikat ISO:

- a) **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

#### **Argumentimi:**

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson

implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- b) **ISO 14001 - 2015 - Standard per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

#### **Argumentimi:**

*Kjo certifikatë mundëson që shoqëria e cila punon/ushton aktivitetin në një zonë prodhimi; e cila përfshin larminë e ajrit, tokës, ujit dhe burimeve natyrore, bimëve dhe kafshëve, dhe qeniet njerëzore dhe shoqërimin e tyre me njëri-tjetrin. Iso 14001 është standardi universal i procesit të monitorimit të përpjekjeve të një organizate drejt mjedisit të saj dhe në një kuptim tjetër të hapave përpara. Është një ndërveprim sistematik që lejon të zbatohet duke i kushtuar vëmendje efekteve rreth tij gjatë periudhës nga faza e parë e prodhimit deri te dorëzimi tek përdoruesit e këtij objekti, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.*

- c) **ISO 45001-2018 Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

#### **Argumentimi:**

*Standarti ISO 45001-2018 është standarde ndërkombëtare, të cilët parashtrajnë kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. Të dy ofrojnë udhëzime që ju ndihmojnë të hartoni dhe ngrini strukturën e kompanisë suaj mbi sigurinë dhe shëndetin në punë – duke ju dhënë mundësinë të sillni të gjithë kontrollin e duhur dhe proceset në një sistem menaxhimi. Përfitimet Standarti ISO*

**45001-2018** Menaxhimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë janë krijimi i kushtet më të mira të punës në gjitha ndermarjet dhe shoqerite, identifikojnë kërcënimet dhe vendosin kontrollin për menaxhimin e tyre, reduktojnë aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën joproduktive të puntoreve, përfshijnë dhe motivojnë stafin me kushte më të mira dhe më të sigurt pune, dëshmojnë përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve të tyre.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundeson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në Kodin e Punës, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin nr.10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM nr. 563, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, VKM nr.312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier si dhe në mbeshtetje të natyrës së objektit të prokurimit.

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim:* Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

*Kujdes:* Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

**Të gjitha materialet e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike.** Referuar udhëzimeve dhe rekomandimeve të APP-së, për zërat në preventive që mund të jetë

paraqitur marke/brand, origjinë apo prodhim specifik, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike.

Specifikimet teknike janë bere për përmbushjen e nevojave të Autoritetit Kontraktor. Materialet i kanë specifikimet e tyre cilësore dhe sasore sipas zerave të secilit në preventive dhe në specifikimet teknike, hartuar për çdo zë punimi sipas preventivit të punimeve, bashkelidhur dokumentave të tenderit.

**Të gjitha materialet e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike. Në rast se në një nga zërat e preventivit është shkruar me emra marke automatikisht do të pranohet edhe një produkt ekuivalent.**

Specifikimet teknike u hartuan nga **DREJTORIA E HARTIMIT TE PROJEKTEVE, SHERBIMEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE** duke marr në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 20/06/2023, ora 11:00.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt "**Përmirësim i teknikave ujitës, skemave të reja e sistemi i pompimit**".

#### **NJËSIA E PROKURIMIT :**

**Arben MANOKU**

**Florian KITA**

**Mitjon NIKOLLA**